

LAJME PIPOL 17
21.01.2013

Kongresi i Dytë European i Psikanalizës
Pas Edipit
Larmia e praktikës psikanalitike në Europë
6 dhe 7 korrik 2013

Tek Sheshi
Brussels Meeting Centre
Mont des Arts, 1000 Bruxelles
(Hyrja e Xhamit)

Përkthim simultan

Në Hollandisht, Anglisht, Frëngjisht, Italisht, Spanjisht

Regjistrim në linjë : <http://www.europsychanalyse.eu/>

Informacione : +32 (0)483365082 info@europsychanalyse.eu

Thirrje për propozime artikujsh për simultanet klinike të PIPOL 6

Forca e simultaneve

Simultanet e Kongresit të dytë të Psikanalizës, PIPOL 6, me titullin « Rasti, institucioni dhe përvoja ime e psikanalizës », do të përbëjnë rastin e ngritjes së një turme e cila nuk flet me një zë të vetëm, por me një pluralitet thëniezimesh singulare. Kështu pra, konform me periudhën e *Pas-Edipit*, ne do ta shtyjmë interesin tonë ndaj shumëllojshmërisë së praktikës psikanalitike në Europë deri në skaj të *një pas një-shit*. Ky lloj i veçantë turme, ku gjithsecili përpiqet të rrokë çfarë e dallon në mënyrë absolute nga gjithkush tjetër, është themeli i « forcës sonë materiale ».

Institucioni i psikanalistit

Për psikanalistin, institucioni është një ligjërim, d.m.th. një modalitet i lidhjes sociale të cilin ai e vendos në vendet ku akti¹ i tij psikanalitik shpaloset. Prapa divanit, analisti vendos një marrëdhënie serioze me « skenën tjetër », mbështet hipotezën se gabimet e ligjëratës « e kanë një domethënie » si dhe manovron dykuptimësinë e shënjesit për të përfutur efekte të së

¹ MILLER J.-A., « Vers PIPOL 4 », Mental n°20, shkurt 2008.

vërtetës. Përveç këtyre tre poleve : së pavetëdijshmes, *subjektit të hamendësuar me dije*, dhe interpretimit, dispozitivi i përcaktuar nga psikanalisti ka veçantinë të lërë bosh vendin e padronit në mënyrë që t'i lejojë subjektit të vendosë *krye-shënjesat* e vet. Ndërkohë që psikanalisti del nga kabineti i tij, kjo nuk do të thotë se ai del edhe nga ligjërimi i tij. Analistët dhe të analizuarit që veprojnë në institucionet e « shëndetit mendor » e mbartin atë me vete. Qoftë padroni, qoftë dija mund t'i zënë këto vende por kjo gjithsesi mbetet një e dhënë shtesë, të cilën praktikanti i psikanalizës duhet ta ketë në konsideratë e ta përfshijë në llogaritë e veprimit të tij. Nga ana tjetër, kjo prani e padronit dhe e dijes e vendos përballë disa rasteve të cilat i ndeshim rrallë në kabinet. Në fakt, subjekti i çorientuar, ai që nuk i zë besë kujt, që nuk arrin dot t'a mbërthejë enigmën e ekzistencës së tij me një domethënie çfarëdo, do të gjejë tek një prani e tillë një lloj lidhjeje sociale, një alternativë bisedore që e ngulit me shënjesin, i përfton identifikime dhe mbështet qenien e tij.

Prapa ekranit të gjuhës

Por për psikanalistin, institucioni nuk kufizohet as te një makinë që prodhon alienim, as te një aparaturë që sendërton identifikimet. Menjëherë sapo subjekti gjen lehtësim në një kuadër bisedor të mbështetur në gjuhën e përbashkët, prakticioni i orientuar nga psikanaliza bën një përpjekje për të mbrojtur singularitetin që i reziston kodit të Tjetrit. Ai përpiket të lexojë *lalangue-n* që i paraprin fjalës së subjektit, shkronjë që do t'i lejojë të nyjëtojë një lidhje simptomatike e cila e anashkalon institucionin e mishëruar tek padroni.

Kur Njëshi-fillikat takon një tjetër

Ne e dimë, që prej PIPOL 5, se rasti i ekspozuar në kongreset tona nuk ekziston si i tillë². Ai është një konstruksion i praktikienit, dhe praktikieni është i pranishëm si Velazquez te *Las Méninas*. Mbetet të njihet nëse ai është i pranishëm me fantazmatikën, idealet, identifikimet e tij apo në të kundërt me stilin e tij më intim, që përcaktuar përgjatë takimit traumatik të shënjesit me trupin. Në momentin që praktikieni fillon të ketë një jehonë të singularitetit të tij, në sferën më private të mundshme në kuadrin e përvojës së tij psikanalitike, ai mund të gërmojë një vend dhe të manovrojë singularitetin e subjektit që i flet. Kjo për të thënë se puna në institucion praktikohet duke u nisur nga ajo çka përvoja e psikanalizës i mëson praktikienit mbi raportin më autentik ndaj reales. Ky raport ndaj singulariteteve dhe ndaj reales, i lehtësuar nga mbrojtjet, i lejon, në funksion të rastit, të përforcoj mbërthimin e subjektit me Tjetrin e Institucionit kur lind nevoja, ose të mbështesë tek subjekti punën me shkronjën, një elaborim të *lalangue-s* së tij, duke i vendosur kështu një kufi ëndjes (*jouissance*) që e pushton³.

² MILLER J.-A., « Parler avec son corps », Mental n°27/28, shtator 2012.

³ CAROZ G., « Introduction aux simultanées cliniques de PIPOL 6 », PIPOL NEWS 2, 01-11-2012

<http://www.europsychoanalysis.eu/index.php/site/page/fr/7/fr/bulletin/#article-box-155>

Ftesë

Ne i ftojmë prakticienët e psikanalizës në Europë për të folur duke u nisur nga ky vend i *prakticienit-të-analizuarit*, duke nyjëtuar : rastin, institucionin dhe përvojën e psikanalizës së prakticienit. Juve, që dëshironi të merrni pjesë tek simultanetë si oratorë, do t'ju kërkohet të ilustroni një ngjarje klinike, duke treguar se si përvoja juaj e psikanalizës ju ka mundësuar të veproni me rastin dhe institucionin, ndërkohë që futni në lojë edhe realen si pikë mbështetëse për aksionin tuaj.

Në mbyllje, ju kujtojmë këtë përkufizim lëvizës (*mobile*) që i kemi dhënë institucionit. Analisti transporton ligjëratën e tij në valixhen e tij. Ai zë vend aty ku ndodhet, nëpërmjet etikës së tij e cila konsiston në thërmimin e universales nga singularja⁴, ai synon pikën *Njëshi-fillikat* që i shpëton institucionit. Si rrjedhojë, të gjithë kolegët janë të ftuar të marrin pjesë tek simultanet klinike të PIPOL 6, edhe nëse institucioni i tyre nuk e tejkalon divanin⁵.

Informacione praktike

Të gjitha seancat simultane do të zhvillohen ditën e parë të kongresit, të shtunën 6 korrik 2013, nga ora 10 deri në orën 13 dhe nga ora 15 deri në orën 18. Tekstet mund të jenë të shkruar dhe të paraqiten në njëër nga pesë gjuhët e kongresit : anglisht, frëngjisht, spanjisht, italisht dhe hollandisht. Duhet t'i dërgohen, që tani deri në 16 prill 2013 në mesnatë, Laura Petrosino-s, sekretaria e simultaneve (mlpetrosino@gmail.com) dhe Gil Caroz-it (gil.caroz@skynet.be). Tekstet e përzgjedhur do të punohen me disa « mentorë », për t'i lejuar çdo oratori të marrë temperaturën e Tjetrit dhe të rafinojë punën e tij përpara Kongresit.

Disa indikacione teknike lidhur me tekstin :

- Teksti nuk duhet të kalojë 9000 shenjat, përfshi këtu hapësirat (*15 min. ligjëratë*)
- Karakteret : Times New Roman.
- Përmasa e shkronjave : 12
- Formati i dokumentit : Document Word 97-2003
- Emri i dokumentit : EMRI-GJUHA (p.sh. : COHEN-FRANÇAIS)
- Në krye të faqes së parë, në qendër : Titulli i tekstit dhe poshtë emri dhe mbiemri juaj.

Gil Caroz
Drejtor i PIPOL 6
EuroFederacioni i Psikanalizës

⁴ LACAN J., « Lituraterre », Autres écrits, Paris, Seuil, 2001, p. 16.

⁵ BASSOLS M., « Présence de l'institution dans la clinique », PIPOL NEWS 4, 13-11-2012
<http://www.europsychoanalysis.eu/index.php/site/page/fr/7/fr/bulletin/#article-box-157>

